



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 40.

Prishtinë, më 30.03.2016 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Sasha Milosavljević, Slavko Simić, Qerim Bajrami dhe Danush Ademi.

Munguan: Fisnik Ismaili, Rustem Berisha, Milka Vuletić dhe Veton Berisha

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : përfaqësuesi i OSBE-së Senad Karaahmetović; përfaqësuesi i KDI-së Artan Murati, përfaqësuesi i Ambasadës së Zvicrës, Hajrudin Skënderi; konsulltant i Sekretariatit të KKK, Zijush Ahmeti dhe Celal Ilić -Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 9.03.2016 dhe 16.03.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryesuesja, konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 9.03.2016 dhe 16.03.2016;**

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 9.03.2016, dhe 16.03.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;

Kryesuesja, theksoi se për arsye të respektimit të procedurave parlamentare, komisioni për sot ka caktuar të vetmën pikë të rendit të ditës, shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës. Ajo kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse ka ndonjë propozim në Projektligj apo në raport me amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Pas diskutimeve në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funksional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Të ndryshme.

Kryesuesja, theksoi se komisioni është në pritje të përgjigjes zyrtare nga ana e partneritetit të OSBE-së, për datën e realizimit të vizitës studimore në Kuvendin e Republikës së Kroacisë.

Në pajtim me qëndrimet e anëtarëve të komisionit, u vendos që me datën 6.04.2016, të ftohet drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, Ivan Tomiq që të raportojë lidhur me implementimin e Strategjisë së Qeverisë, e cila ka të bëjë me koordinimin e çështjeve për komunitetet.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Zhivković